



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT**

**RREGULLORE
PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE
NË AIDSSH**

MIRATUAR

VENDIMI I AUTORITETIT

NR.13, DATË 14.04.2017

Prill 2017

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, bazohet në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe nga nëpunësit e Sekretariatit Teknik.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 4

Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).
2. "Institucion epror", për Autoritetin është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Roli “epror” ushtrohet në përputhje me ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucionit të pavarur të krijuar me ligj dhe Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”. Eprorët e zyrtarëve në Sekretariatit Teknik të AIDSSH-së janë: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtor i Arkivit, Drejtor i Informacionit, Drejtor i Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve, Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financave dhe Drejtor i Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik.
3. "Person i lidhur me një zyrtar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, sipas

përcaktimit të pikës 11, të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

4. "Parim i proporcionalitetit" (sipas pikës 12 të nenit 3 të ligjit 9367, datë 7.4.2005), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5

Fusha e zbatimit

1. Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

- a) çdo zyrtar i AIDSSH-së, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367 datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003, të ndryshuar.
- b) çdo zyrtar i AIDSSH-së, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;
- c) çdo zyrtar i AIDSSH-së kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
- d) personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe në nenin 30 të ligjit nr.45/2015 Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 6

Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i) hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
 - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
 - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
 - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
 - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e

përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

- vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Autoritetit për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për biznesin, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike vendore dhe administrimin financiar;
 - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga Autoriteti Përgjegjës në AIDSSH, si dhe nga zyrtarët-eprorë në këtë Institucion.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005.
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.

Neni 8

Interesat privatë

1. Interesat private të një zyrtari janë interesat që parashikohen nga neni 5 i ligjit 9367, datë 07.04.2005, e konkretisht:
 - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
 - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
 - d) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
 - e) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
 - f) marrëdhënie:
 - i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;
 - iii) etnike;
 - iv) fetare;
 - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
 - g) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
 3. Nëse në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe anasjelltas.
 4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtari nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

Neni 9

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1, 2 e 3 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtarët, kur kjo kërkohet

nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohe dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave private në Autoritetin për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Eprorët e AIDSSH-së me mbështetjen e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe në bazë të vetdeklarimit të zyrtarit të këtij institucioni, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masa e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash.
4. Titullari i Institucionit merr masa që zyrtarit të mos t'i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash.

Neni 10

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit është:
 - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijani;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijani dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari të Autoritetit, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. AIDSSH-ja vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Autorizimi dorëzohet në Autoritetin Përgjegjës të AIDSSH-së, i cili e administron atë gjatë gjithë periudhës që zyrtari është në marrëdhënie pune në Institucion.
3. Në rastin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Autoritetit, autorizimi dorëzohet në Autoritetin Përgjegjës të AIDSSH-së dhe vihet në dispozicion, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës.

Neni 12

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti Qendror Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
 - a) Kryetari dhe anëtarët e Autoritetit;
 - b) Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit;

- c) Drejtorët e Drejtorive të Autoritetit;
 - d) Përgjegjësit e Sektorëve të Autoritetit;
3. Autoriteti Përgjegjës në AIDSSH, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07-04-2005, i ndryshuar dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje janë strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financave në AIDSSH, të përcaktuara me urdhër të titullarit të AIDSSH-së.
 4. Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e Autoritetit Përgjegjës të AIDSSH-së, të vendosen kritere dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të Autoritetit Përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 13

Detyrat e autoritetit përgjegjës të AIDSSH-së

1. Autoriteti Përgjegjës i AIDSSH-së kryen detyrat e parashikuara në Udhëzimin Nr. 1 , datë 27.6.2014 “Për Krijimin, Funkcionimin dhe Përgjegjësitë e Strukturave të Autoriteteve Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesave, në Institucionet Publike” si dhe çdo detyrë tjetër sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe nr.9046, datë 10.4.2003, të ndryshuar dhe çdo akti nënligjor dalë në zbatim të tyre.
2. Autoriteti Përgjegjës në AIDSSH veçanërisht kryen detyrat:
 - a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të AIDSSH-së;
 - b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t’u lëshuar nga zyrtarët e AIDSSH-së, sipas nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe nenit 9 të kësaj rregulloreje;
 - c) krijojnë regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
 - d) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të AIDSSH-së, u sugjerojnë atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
 - i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
 - e) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
 - f) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
 - g) në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore:
 - i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt të interesit, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin strukturën përgjegjëse në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit të zyrtarëve përgjegjës;
 - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të AIDSSH-së, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së;
 - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së,

për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;

- iv. marrin masa për të miratuar në rregulloret e brendshme të Institucioni, sipas udhëzimeve e orientimet e lëshuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.
- h) mbështesin dhe kryejnë detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin e procesit të deklarimit të interesave nga zyrtarët e AIDSSH-së;
- i) bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e AIDSSH-së për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
- j) njofton me shkrim ILDKPKI-në për rastet e emërimeve apo largimeve të zyrtarëve të AIDSSH-së të cilët mbartin detyrim për deklarim të interesave private,
- k) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-së për zyrtarët e AIDSSH-së;
- l) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të titullarit dhe ILDKPKI-ja në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.

Neni 14

Administrimi i dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga Autoriteti Përgjegjës, në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Në rast largimi nga detyra, bëhet dorëzimi i gjithë dokumentacionit sipas rregullave të caktuara.
2. Për administrimin e këtij dokumentacioni Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajë disa dosje:
 1. Dosja nr. 1 me titull “Për aktet ligjore dhe nënligjore” duhet të përmbajë:
 - a) Ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
 - b) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
 - c) Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
 - d) Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - e) Ligjin 119/2014, date 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
 - f) Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 - g) Ligji nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
 - h) Komentaret Ligjorë të ILDKPKI-së;
 - i) Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI -së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
 - j) Botime të tjera të ILDKPKI -së.
 2. Dosja nr. 2 me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë :
 - a) Regjistri i konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
 - b) Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave;
 - c) Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
 - d) Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për

- konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- e) Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë;
3. Dosja nr. 3 me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që bartin detyrimin për ILDKPKI-në” duhet të përmbajë:
- Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
 - Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklaram dhe konfirmimet e tyre;
 - Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
 - Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
 - Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

Neni 15

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

- Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të AIDSSH-së, krijohet regjistri me të njëjtin emër, i cili administrohet nga struktura përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore, pjesë e Autoritetit Përgjegjës në AIDSSH.

Neni 16

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti Përgjegjës i AIDSSH-së, struktura përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financave për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesit, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, nga Kuvendi ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave privatë

Neni 17

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave privatë

- Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve, bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.
- Zyrtarët e AIDSSH-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklaram të interesave private periodike janë:

- a) Kryetari dhe anëtarët e Autoritetit;
 - b) Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit;
 - c) Drejtor i Drejtorisë së Arkivit;
 - d) Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik ;
 - e) Drejtor i Drejtorisë së Informacionit;
 - f) Drejtori i Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve;
 - g) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financave.
3. Gjithashtu, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sipas gjendjes familjare, të përcaktuar në çertifikatë për periudhën e deklarimit.
 4. Fëmijët madhorë të zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, që nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me ta, të përcaktuar në çertifikatë për periudhën e deklarimit, si dhe persona të tjerë të lidhur me zyrtarin, bëjnë deklarim të interesave, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm, kur kjo gjykohet e domosdoshme nga ky i fundit.
 5. Çdo zyrtar, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILDKP, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financave, në veçanti Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, si dhe Sektori i Financës nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 18

Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht

Interesat privatë, që deklarohen periodikisht janë ato të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.

Neni 19

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruar nga zyrtarët e AIDSSH-së, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
 - a) Zyrtari i AIDSSH-së, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, (qoftë ky dhe subjekt i AIDSSH-së) dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
 - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i AIDSSH-së, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1, shkronja b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të AIDSSH-së është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) kur zyrtari i AIDSSH-së:
 - i. ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - ii. ose vetëpërjashtimi i tij është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
 - iii. ose për shkak se asnjëra nga zgjidhjet e parashikuara në nenin 23, pika 2 të kësaj rregulloreje nuk është e mundur;
 - b) dhe kur:
 - i. vendimet e zyrtarit, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
 - ii. nuk është i mundur as transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
 - iii. nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga Kuvendi, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 20

Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Kryetari dhe Anëtarët e Autoritetit.
 - a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
 - b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
 - c) nuk mund të jetë anëtar i partive politike dhe nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre;
 - d) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.
 - e) Qenia anëtar i Autoritetit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore apo private.
2. Zyrtarët e tjerë të përcaktuar në pikat b), c), d), e), f) dhe g) të nenit 17 të kësaj rregulloreje:
 - f) nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
 - g) nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
 - h) nuk mund të jene anëtar të partive politike dhe nuk mund të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre;
 - i) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të AIDSSH-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me shoqërinë në fjalë,

rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;

Neni 21

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në AIDSSH të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në AIDSSH, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në AIDSSH, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
 - a) “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004;
 - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004;
5. Në asnjë rast zyrtari i AIDSSH-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përfshihen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 22

Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e AIDSSH-së, për kufizimet e interesave privatë të këtyre zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje janë:
 - a) bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, bashkëjetuesi/ja e zyrtarit, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, apo të bashkëjetuesit/es.
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e AIDSSH-së-së, të përcaktuara në këtë rregullore,

zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 23

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/nëpunësit e AIDSSH-së bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.
2. Disa nga mënyrat bazë të mënjanimin të konfliktit të interesit janë:
 - t'i kufizohen zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
 - të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
 - të mos lejohet që zyrtari/nëpunësi të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
 - të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e zyrtarit, pjesë e drejtorive të Sekretariatit Teknik në AIDSSH;
 - të transferohet zyrtari i Sekretariatit Teknik të AIDSSH-së në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
 - të merren masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari të Sekretariatit Teknik të AIDSSH-së në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
 - në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose të revokohen, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
 - anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
 - anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i zyrtarit, kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

Neni 24

Sanksionet

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar dhe në këtë rregullore, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe/ose shkelje disiplinore dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar në nenin 44 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.

Neni 25

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të AIDSSH-së, të drejta që të ndërmarin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon

cenimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Miratur me Vendimin nr. 13, datë 14.04.2017 të AIDSSH-së.